

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 07 MARS 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Sot jemi thirrur në një debat për të cilin të gjithë bashkë ndajmë të njëjtën ndjenjë solidariteti të padiskutuar për këtë ngjarje, më të rëndën, që besoj se njerëzimi nuk do të donte ta dëgjonte, që pas Luftës së Dytë Botërore, por që tashmë është një fakt i kryer. Është e qartë për të gjithë ne se nuk jemi aq të mëdhenj sa të mendojmë që me fjalën tonë i japim zgjidhje këtij problemi, por kemi detyrën e madhe që në këtë pjesë që kemi të demonstrojmë, në radhë të parë e mbi të gjitha, që jemi principalë dhe luajalë, thënë në shqip: parimor dhe të ndershëm në atë që bëjmë. Në këtë moment agresioni është edhe momenti i ndarjes së gjërave qartë: kush është në krah të kujt dhe me sa sinqeritet qëndron. Është një botë e tërë përballë, që i është kundërvënë Ruisë agresore e pushtuese dhe aleatëve të saj, të cilët kanë demonstruar qartë dhe pa ekuivok se cilët janë. Shqipërisë së vogël, e vetmja gjë që s'mund t'i lejohej kurrën e kurrës është që të kishte një pozicion të paqartë në këtë mes. Prania e saj në një marrëdhënie të ngushtë, preferenciale, të jashtëzakonshme, anormale, siç është marrëdhënia e Shqipërisë qeveritare me Serbinë, në të ashtuquajturin "Ballkan i hapur", është pa diskutim një nga provat më të shëmtuara të vendosjes së shtrembër të Shqipërisë në një moment kaq delikat dhe kritik botëror. Pa ndalur në atë se çfarë ka thënë Vuçici, Presidenti i Serbisë, dhe çfarë ka bërë, duke refuzuar sanksionet ndaj Ruisë, është mirë të hedhim dritë se çfarë qëndrimi ka e tërë Serbia politike lidhur me këtë çështje.

Në "Ballkanin e hapur" ne jemi në krah të Serbisë, të një Vuçici që refuzon sanksionet. Po çfarë bën kryetari i parlamentit të tij, Daçiç, figura e dytë e shtetit serb? Ai thotë, fjalë për fjalë: "Ata, europianët, euroatlantikët, do të kërkojnë anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe OKB. Kujt mund t'i drejtohem, - bën pyetjen kryetari i parlamentit, Ivica Daçiç, dhe kthen përgjigje po vetë: vetëm Ruisë dhe nëse i vëmë sanksione nuk kemi kujt t'i drejtohem". Pra, bllokim me çdo kusht, me çdo mjet, me çdolloj aleance për të mos e lejuar Kosovën të bëjë para. Shkojmë te pjesa tjetër, se të gjithë njerëzit shprehin që mund të jetë një Serbi, ku një pjesë mund të jetë më mendjehapur, më europiane. Ja çfarë thotë kandidati për president i opozitës së bashkuar, Sdravko Ponos: "Asnjë qeveri e zgjedhur në mënyrë demokratike nuk duhet ta njohë Kosovën si shtet i pavarur". Pra, janë shumë të qartë dhe të egër kundër Kosovës këta miqtë e mëdhenj të qeverisë së Tiranës në "Open Ballkan". Si ka mundësi që ne sot miratojmë një rezolutë, e cila në pjesën e parë, hyrëse të saj ka disa elemente parimore, të cilat gjenden në çdo rezolutë tjetër, ndërkohë që kemi një frikë të tmerrshme, maxhoranca, sigurisht, se ne po e themi haptazi, që të shqiptojmë fjalën "Serbia"?

Gjithmonë Europa është treguar më e kujdesshme, më diplomatike, më e moderuar në termat e saj, po çfarë po bën në këtë moment Europa? Në këtë moment Europa ka marrë pozicionin e saj të qartë dhe të prerë, ka rrëzuar tabutë e saj, siç ka qenë edhe furnizimi me armë e të tjerë, dhe në rezolutën e saj, pra të Parlamentit Europian, (ndonëse këtu ka më europiane se europianët, më të moderuar se të moderuarit dhe më diplomatë se diplomatët po të jetë për Serbinë), në pikën 38 thuhet: "Bashkimi Europian thekson me shqetësim të madh përpjekjet e vazhdueshme të Ruisë për destabilizimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor (jemi ne vendet e Ballkanit Perëndimor) dhe ndërhyrjen në proceset

e tyre demokratike. Bashkimi European denoncon ata që i shprehën mbështetje Federatës Ruse pas agresionit të Ukrainës dhe përgëzon ata që e mbështetën. Shprehim keqardhjen e madhe për mosangazhimin e Serbisë në sanksionet e BE-së kundër Rusisë”. Ku është Shqipëria këtu?! Ku ndodhet? Kolegët deputetë duhet ta kenë shumë siklet që kemi një rezolutë, e cila është shumë më pak kritike sesa ne që e kemi rrezikun te pragu i derës. Të gjithë e kanë konsideruar qartë që përshkallëzimi i konfliktit në Rusi një hap të ri do të ketë Ballkanin dhe duke pasur një shtet si Serbia, me orientime shumë të qarta shoviniste, rreziku kryesor bie, në radhë të parë, mbi Kosovën dhe në situatën që ata mbajnë, ndaj së cilës ne nuk mbajmë asnjë pozicion. Po çfarë është kjo? Ne mbështesim dhe mirë bëjmë, patjetër, me gjithë zemër, sakrificën e jashtëzakonshme të popullit të në Ukrainës, por në të njëjtën kohë ata që e kanë linjën ajrore Beograd-Moskë të hapur, si asnjë tjetër në Europë, i kemi ngjitur e ngjitur dhe kemi “Ballkanin e hapur” bashkë me ta.

Në Moskë arrestohen se protestojnë për paqe, në Beograd bëhet protestë e madhe në mbështetje të agresionit rus dhe shpalosen flamujt rusë. Kushedi sa medie ruse janë bllokuar, që dezinformojnë, në bazë të strategjisë së Putinit, si pjesë e luftës, opinionin botëror, ndërkohë që dhjetëra medie serbe vazhdojnë të dezinformojnë pafundësisht. E kanë marrë rolin e asaj që nuk bëjnë dot mediet ruse dhe ne qëndrojmë fort te “Ballkani i hapur”. Sigurisht, në një situatë të tillë nuk na duhen fjalë të mëdha, por na duhen veprime, të cilat flasin vetë, që e kanë shpjegimin, e tregojnë ndjeshmërinë, e tregojnë luajalitetin, në radhë të parë e mbi të gjitha edhe për njerëzit shqiptarë, sepse dalja e menjëhershme nga “Ballkani i hapur” është e vetmja gjë që na ndihmon ekonomikisht, sepse dëmet dhe shkatërrimi që u ka sjellë në mënyrë të veçantë fermerëve shqiptarë është fakt i kryer. Të gjithëve duhet t’u vijë turp që qumështi shqiptar derdhet nëpër trotuare dhe qumështi serb shitet, e njëjta gjë edhe për shumë produkte të tjera, për të cilat nuk dua t’ju marr kohë që t’i numëroj. Cili do të ishte qëndrimi në këtë rast? Dalja e menjëhershme nga ky mekanizëm, nga ky kompromis i shëmtuar, i errët i kulisave jo më në emër të një dhënie bese të pabesë, të ndarë midis Kryeministrit tonë dhe atij të Serbisë. Ne nuk pranojmë të ndryshojmë asgjë dhe të bëjmë një rezolutë, e cila do të ngjante me atë të një vendi që nuk di se sa larg mund të jetë në glob, sepse edhe vendet më të largëta janë treguar shumë të prera ndaj kësaj. Ndaj, pikërisht për këtë arsye, unë kam paraqitur një amendament për rezolutën e sotme (deputetët janë njohur), që është një moment përbashkues, jo moment ndarës.

Unë nuk besoj se ndahemi për “Ballkanin e hapur”, apo jo? Unë nuk besoj se ne jemi në dy kahe të kundërt, sepse ne duam që Shqipëria të ndahet nga ata që përkrahin agresorët; ne nuk ndahemi pse Shqipëria do të ndahet nga një marrëveshje që varfëron fermerët, kurrën e kurrës ne nuk mund të ndahemi për një marrëveshje me një vend, që për jetë a vdekje e ka mision që Kosova të mos njihet kurrë dhe të pengohet me çdo kusht e me çdo mjet. Ne këtu bashkohemi, nuk ndahemi. Rezoluta pasurohet, nuk varfërohet. Ne i afrohem Europës, e cila flet me gjuhë të qartë dhe i vë emër Serbisë, por këtu struken e tremben se mos përmendet Serbia, se mos prishet qejfi apo idili, që funksionon prej javësh, muajsh e vitesh ndërmjet tyre. Ndaj, thelbi i amendamentit që unë kam paraqitur ka qenë shumë i thjeshtë dhe i qartë: dalja e menjëhershme e Shqipërisë nga kjo nismë, shfuqizimi i të gjitha marrëveshjeve dhe vendimeve të qeverisë dhe nismave ligjore të marra në kuadër të “Ballkanit të hapur”, ndalimi i çdo veprimtarie dhe instrumenti të ngritur në funksion dhe në zbatim të vendimeve dhe akteve që lidhen me “Ballkanin e hapur”. Pra, çdo gjë është e qartë dhe e thjeshtë. Në krah të NATO-s, në krah të BE-së, në krah të Parlamentit European, të të gjithë botës së përparuar, që është për paqen kundër luftës, dhe kundër atyre që i kanë dalë në krah luftës, të cilët Parlamenti European me 637 vota u ka vënë gishtin. Kjo sigurisht që na bashkon.

Unë nuk e imagjinoj dot se si mund të ndahemi dhe ta rrëzojmë këtë amendament e të bëhemi shumë më diplomatë se diplomatët e shumë më europianë se europianët e moderuar dikur, që sot kanë rrëmbyer armët e po ndihmojnë me gjithçka që kanë ukrainasit. Sigurisht, kjo do të ishte edhe një

provë vërtetësie me shqiptarët, por edhe me ukrainasit, duke mos përkrahur dhe mos u qëndruar në krahë atyre që mbështesin pushtuesit e tyre. Faleminderit!